

Organizata Jo-qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe  
EC MA NDRYSHE

**Involvimi i komunitetit në procesin e vizionimit të shfrytëzimit të hapësirës së bunkerit nëntokësor në lagjen “Ortakoll”, Prizren**



Përpiluan:

Elmedinë Morina, BA ark

Mrinë Godanca, BA ark

## **Përmbajtja:**

### **1.0** Hyrje

### **2.0** Lokacioni dhe hapësira e bunkerit – Gjendja ekzistuese

### **3.0** Dizajni i procesit hulumtues

#### **3.1** Metodologjia e zhvillimit të punëtorive

### **4.0** Rezultati – Të dalat nga punëtoritë

### **5.0** Koncept idea e vizionit

#### **5.1** Përmbajtjet dhe funksionet

#### **5.2** Menaxhimi i hapësirës së bunkerit

#### **5.3** Parku – Hapësira e përbashkët e hapur e bllokut të banimit

### **6.0** Përmbyllje

## 1.0 Hyrje

Rimendimi i hapësirës së bunkerit nëntokësor në lagjen “Ortakoll” në Prizren është iniciativë e EC Ma Ndryshe për dizajnimin e vizionimit të mënyrës së shfrytëzimit të këtyre hapësirave në bashkëpunim me banorët e lagjes dhe qytetarët në përgjithësi.

Dizajni me participim të komunitetit është forcë shtytëse drejt ndryqshimit të qasjes në menaxhimin e hapësirave të përbashkëta të qytetit apo lagjes. Kjo metodë i tejkalon kufizimet e proceseve tradicionale të projektimit dhe promovon principin e përfshirjes së qytetarëve në fazën e krijimit dhe menaxhimit të hapësirave në vend të trajtimit të tyre vetëm në principin e shfytëzuesve pasivë.

Ky përshkrim paraqet procesin me pjesëmarrje të komunitetit në punëtoritë e organizuara mbi rimendimin e shfrytëzimit të hapësirës së bunkerit nëntokësor dhe asaj të parkut të përbashkët të lagjes mbi sipërfaqe, metodologjinë qasëse dhe rezultatet e fituara nga i gjithë procesi si tërësi, përfshirë vizionin për shfrytëzimin e hapësirave të studiuara.

## 2.0 Lokacioni dhe hapësira e bunkerit – Gjendja ekzistuese

Lagja “Ortakoll” gjendet në pjesën veriore të qytetit, me sipërfaqe të madhe banuese në kategorinë e banimit të ulët dhe atij të lartë. Në përbërjen e stabilimenteve publike lagjja përmban tregun e gjelbër dhe shkollën fillore “Abdyl Frashëri”. Përveç qendrës tregtare, në lagje, kryesisht në përdhësat e objekteve shumëbanesore, funksionojnë edhe një numër lokalesh afariste shërbyese.

Në sipërfaqen mbitokësore të bunkerit, por me dimensione disa herë më të mëdha, pozicionohet parku i përbashkët i bllokut banimor, me sipërfaqe të gjelbrimit kryesisht të ulët, shtigje për kalim, një numër ulësesh, dhe dy fusha sportive.

Në bazë të metodës së vëzhgimit janë identifikuar elementet kryesore përbërëse të parkut në numër dhe gjendje fizike ekzistuese të paraqitura si në **fig. 1**.

Në anën jugore të parkut, me një pjesë mbi sipërfaqen e tokës dhe në afërsi me një fushë sportive, pozicionohet bunkerit i dytë i lagjes, i cili në bazë të përshkrimit nga banorët, është disa herë më i vogël se i pari.

Bunkerit nëntokësor me hapësirat e tij gjendet tërësisht nën sipërfaqen e tokës, në nivel afërsisht -3.1m, me qasje përmes shkallëve me hyrje në pjesën e hapur të parkut. Objekti përbëhet nga dy hapësira të ndara, me përbërje dhe dimensione identike të pasqyruara. Në tërësi, objekti përfshin një sipërfaqe rreth 530m<sup>2</sup>, me dy salla me dimensione nga 175m<sup>2</sup> dhe hapësira tjera përcjellëse me sipërfaqe më të vogla. **Fig. 2**

Në bazë të vizitës brenda objektit, konstatohet gjendje fizike kryesisht e mirë dhe strukturë e qëndrueshme. Problemet paraqiten te kanalet e drenazimit të cilët nuk kryejnë funksionin e tyre, me ç'rast në raste të reshjeve atmosferike, uji qëndron për një kohë të gjatë brenda hapësirave të mbyllura dhe koha e drenazimit të tij pastaj varet nga kushtet tjera klimatike përfshirë dhe temperaturën e jashtme.

Hapësirën e brendshme e përbëjnë vetëm konstruksioni dhe strukturat ndarëse – muret, pra, asnjëra nga kthinat nuk përmban elemente tjera plotësuese si elementet e kthinave sanitare, dyert, kanalet e ventilimit dhe trupat ndriçues.



Fig.1 Ortofoto e zones përreth parkut mbi bunker




Fig. 2 Baza e bunkerit me hapësirat ekzistuese me dimensione të përafërta



Dukje të hapësirës së parkut mbi sipërfaqen e bunkerit



Dukje të hyrjes dhe hapësirave të brendshme të bunkerit

### **3.0 Dizajni i procesit hulumtues**

Procesi hulumtues mbi lokacionin dhe objektin e bunkerit me përmbajtjet përreth është përpiluar në bazë të studimit të qasjes dhe metodave të përshtatshme për hulumtim sipas rrethanave dhe faktorëve të caktuar. Dizajni i procesit përfshin mbledhjen e informatave në forma të ndryshme mbi rastin në studim, caktimin e grupeve të targetuara, organizimin e punëtorisë me këto grupe, intervistat me një numër më të gjerë të personave relevantë, procesimi i të dhënave të dala nga hulumtimi dhe vizioni i konceptit për shfrytëzimin e hapësirës.

Mbledhja e informatave bazike mbi objektin është bërë përmes konsultimit me përgjegjësit komunalë, studimi i historisë dhe planit të lagjes si dhe nga vizita në terren, ku janë bërë matjet dhe vëzhgimet mbi gjendjen dhe kushtet ekzistuese të hapësirave.

Për të organizuar punëtorinë e përbashkët me banorët e lagjes dhe qytetarët tjerë, është bërë caktimi i grupeve të synuara për pjesëmarrje dhe kontribut. Në punëtori kanë marrë pjesë 10 persona, 9 prej të cilëve janë banorë të lagjes, nga të cilët 2 të rinj nën moshën 18 vjeçare, 2 të moshës mbi 30 vjeç, 2 të moshës së mesme dhe 3 të moshuar. Për të arritur diversitetin në mendime dhe nevoja, përveç përfaqësimit të moshave të ndryshme janë marrë parasysh edhe kërkesat e personave me aftësi të kufizuara me një pjesëmarrës përfaqësues të organizatës përkatëse.

Për të përfshirë më shumë opinione rreth rimendimit të shfrytëzimit të hapësirës, është parë e nevojshme mbajtja e një punëtorie të dytë, me përfshirjen e personave tjerë të profileve të ndryshme nga të parët. Punëtorja e dytë është zhvilluar me 8 pjesëmarrës, prej të cilëve, 1 person përfaqësues i komunës, 1 përfaqësues i shoqërisë civile dhe 6 banorë të lagjes, ku përfshihen 3 të rinj mbi 18 vjeç, 2 persona të moshës së mesme dhe 1 i moshuar.

Përveç punëtorive, programi ka paraparë edhe zhvillimin e intervistave për të marrë edhe mendimin e një numri më të madh të personave. Ato kanë mbledhur mendimet e shumë prej banorëve të zonës, rezultatet e së cilave i janë bashkangjitur të dalave nga të dy punëtoritë.

### **3.1 Metodologjia e zhvillimit të punëtorive**

Në punëtoritë e mbajtura me 18 dhe 31 prill 2016 është konsideruar mënyra e qasjes së qytetarëve ndaj hapësirës si ambient i përbashkët për shfrytëzim, ndaj komunikimit dhe bashkëpunimit mes komunitetit dhe me pjesën tjetër të qytetit.

Metodologjia e përdorur është krijuar në bazë të hulumtimit mbi rastet e studimit për dizajnimin e hapësirave me pjesëmarrje të komunitetit dhe është përshtatur sipas rastit dhe grupeve konkrete. Metodot e paraqitura më poshtë janë klasifikuar si formë e përshtatshme për nxitjen e debatit, nxjerrjen e informatave, nevojave dhe kërkesave në plan më të gjerë në mënyrë që të identifikohen nevojat primare për mirëqenie sociale së pari brenda komunitetit dhe në marrëdhënie me qytetin, dhe përkthimi i tyre në elemente përbërëse të konceptit propozues.



### **3 metodat kryesore:**

- 1.** Identifiko në hartë dhe shëno faktorët negativë, ata që nuk funksionojnë për lagjen  
Identifiko nevojat e lagjes dhe potencialet që ka për përmirësim në aspektin e analizuar.
- 2.** Identifiko në hartë dhe shëno faktorët negativë, ata që nuk funksionojnë për parkun dhe zonën rreth bunkerit  
Identifiko nevojat e kësaj hapësire dhe potencialin për përmirësimin e performancës së saj.
- 3.** Shqyrto dhe shëno përparësitë, mangësitë dhe mundësitë për shfrytëzimin në forma të ndryshme të hapësirës së brendshme të bunkerit në bazë të nevojave dhe kërkesave si pjesë e komunitetit.

Këto metoda janë përzgjedhur duke u nisur nga principi i “zoom out” apo i hulumtimit duke filluar në shkallë më të gjerë, në mënyrë që drejtuesit e punëtorisë, por edhe vetë banorët të shqyrtojnë nevojat themelore të komunitetit dhe mirëqenies së tij, për të vazhduar drejt fokusimit në pika kyçe të detyrës dhe përpilimi i zgjidhjeve bazike me të cilat mund të përmirësohen apo të mbulohen një pjesë e konsiderueshme e tyre.


Kjo, sepse njohja e një problemi në nivel më fundamental të tij ndihmon në gjetjen e zgjidhjeve më të thjeshta dhe efikase në të gjitha nivelet e konsideruara.

Me identifikimin e problemeve, nevojave dhe potencialeve të lagjes në tërësi në metodën e parë, është mundësuar të kuptuarit e relacionit brenda komunitetit dhe e komunitetit me qytetin. Në metodën e dytë është bërë e mundur të kuptuarit e mënyrës së shfrytëzimit të hapësirave të përbashkëta sociale, identifikimi i mungesave dhe përparësive, të cilat konsiderohen si mundësi për akomodim brenda bunkerit si hapësirë shtesë për plotësimin e këtyre nevojave, që shënon kalimin në përdorimin e metodës së tretë, ku pjesëmarrësit diskutuan mbi numrin dhe llojin e aktiviteteve që mund të zhvillohen brenda. Një numër aktiviteteve të propozuara dalin nga mungesa e tyre në mesin e aktiviteteve tjera që zhvillohen në lagje, por u propozuan edhe aktivitete tjera mbi bazën e karakteristikave të bunkerit.

Vizita fizike brenda bunkerit nuk është bërë e mundshme për pjesëmarrësit e punëtorisë, por ata janë njoftuar mbi gjendjen dhe kushtet fizike të objektit përmes fotografive të siguruar nga EC Ma Ndryshe dhe drejtuesit e punëtorisë.



Dukje nga punëtorja e parë



Dukje nga punëtorja e dytë

Para ushtrimit të metodave është mbajtur një prezantim i shkurtër mbi cilësitë dhe karakteristikat e hapësirave në shqyrtim, kurse në fund punëtoritë janë përmbyllur me rishikimin e të dalave nga ushtrimi, është formuluar konkludimi i përgjithshëm i dalë nga procesi, ku pjesëmarrësve u është dhënë mundësia të shtojnë mbi to.



#### 4.0 Rezultati – Të dalat nga punëtorja

Pas procesimit të të dhënave të dalura nga punëtoritë në formë të diskutimeve dhe ushtrimeve praktike është arritur deri te gjenerimi i disa pikave kryesore të fokusimit përgjatë dy takimeve, të cilat pasqyrojnë nevojat dhe kërkesat më të shpeshta të pjesëmarrësve.

Meqenëse në fillim të secilit takim u është kërkuar pjesëmarrësve të mendojnë mbi identifikimin e faktorëve negativë që ndikojnë funksionimin e mirë të hapësirës së përbashkët, është mundësuar evidentimi i faktorëve që përsëriten. Ndër nevojat dhe problemet më të përsëritura janë: mungesa e ndriçimit në hapësira të jashtme, nivelii ulët i sigurisë gjatë natës, mungesa e shtigjeve të përshtatshme për ecje në parkun e përbashkët, mungesa e parkingjeve, pengesat në qarkullim me automjete, uzurpimi i hapësirave të gjelbra pranë objekteve të banimit nga lokalet shërbyese, përmbajtjet jo të përshtatshme për profilin urban të lagjes përgjatë rrugëve kufizuese, mungesa e hapësirave të rregulluara për pushim, mungesa e hapësirave për lojë dhe aktivitete fizike, mungesa e një objekti për takimet e komunitetit, prania e qejve endacakë dhe i personave të padëshiruar si mungesë e nivelit të sigurisë.

Ndër faktorët pozitivë me të cilët funksionojnë hapësirat e përbashkëta janë cekur: mirëmbajtja e hapësirave të gjelbra nga kompanitë e angazhuara, mbledhja e rregullt e mbeturinave, afërsia me tregun e qytetit, vullneti i banorëve për angazhim drejt ripërtrirjes dhe mirëmbajtjes së hapësirës së bunkerit me rastin e rifunksionalizimit të hapësirave të tij, sipërfaqja e madhe e brendisë së bunkerit e aftë për adaptim dhe entuziazmi i madh i fëmijëve dhe të rinjve për shfrytëzimin e këtyre hapësirave në të ardhmen, me ide të qarta shfrytëzimi nga ta.

Si potenciale për zhvillim janë cekur: afërsia e bunkerit me hapësirat e përbashkëta të hapura, numri i madh i hapësirave të gjelbra përreth objekteve të banimit, posedimi i fushave sportive të lagjes, pozita qendrore e bunkerit dhe parkut në kuadër të bllokut të objekteve shumëbanesore, shfrytëzimi i vazhdueshëm nga të gjitha moshat dhe sipërfaqja e madhe e hapësirave të përbashkëta si kriter për të ofruar fleksibilitet dhe diversitet të funksioneve.



Problemet e shtrura dhe propozimet në formë të shkruar nga qytetarët mbi harta dhe bazë

Në dy punëtoritë e organizuara me qytetarë, por edhe në bazë të intervistave shtesë, ata janë treguar entuziastë dhe të hapur ndaj ndryshimit dhe adaptimit të funksioneve të reja brenda hapësirave të bunkerit.

Në të dyja takimet është diskutuar për propozimet në dy aspekte – në atë organizativ/menaxherial dhe atë fizik.

Sa i përket organizimit fizik, pjesëmarrësit pajtohen gati njëzëri për shfrytëzimin e hapësirës së bunkerit kryesisht nga banorët e lagjes dhe atë nga të rinjtë. Megjithatë, nuk përjashtojnë, madje inkurajojnë prurjen e disa aktiviteteve të qytetit që i përshtaten karakterit të lagjes dhe të cilat do të lidhnin këtë pjesë me pjesën tjetër të qytetit në sensin kulturor dhe argëtues.

Disa nga funksionet e përmendura përfshijnë: qendër e komunitetit, qendër e kulturës, kinema, galeri, muze, diskotekë, pishinë e mbyllur, qendër rinore e rekreative, qendër sportive, e edukimit dhe hapësirë multifunkcionale për të takuar nevojat e ndryshme të komunitetit.

Në aspektin e menaxhimit të hapësirës, shumë nga pjesëmarrësit konsiderojnë akomodimin e bizneseve të vogla në njërën pjesë të hapësirave të bunkerit, hap ky i cili do të ndihmonte drejtimin e hapësirës dhe do t'i sillte fitim lagjes dhe komunës. Nga idetë e përmendura veçohen: pishina e mbyllur e qytetit, hapësirë për mbjelljen e të mirave bujqësore që nuk kërkojnë dritë, si kërpudhat, zhvillimi i bizneseve sportive/rekreative, si fitnes dhe kinema e vogël e shfrytëzuar në relacion me aktivitetet kulturore të qytetit.

Në anën tjetër, hapësira e parkut mbi bunker shihet si potencial për nxitjen e bashkëpunimit mes komunitetit, ku sipas banorëve propozohet rregullimi i hapësirave për pushim, lëvizje, lojë e rekreacion, shtimi i sigurisë përmes ndriçimit adekuat gjatë natës, mbjelljen e sipërfaqeve me gjelbërim më të lartë, pajisja e parkut me mobiluarin adekuat dhe në sasi të mjaftueshme. Sipas tyre, kjo do të mundësonte rregullimin e marrëdhënieve në lagje, largimin e vizitave të padëshiruara që dëmtojnë profilin e lagjes dhe organizimin e një numri më të madh të aktiviteteve për të rinjtë dhe të moshuarit.

## 5.0 Koncept idea e vizionit

Natyrë e projektit nxit ngritjen e zërit ndaj pengesave të krijuara në funksionimin adekuat të hapësirave të përbashkëta përreth objekteve të banimit dhe adresimin e duhur të tyre për të fituar rezultate përfillëse ndaj nevojave dhe kërkesave të komunitetit. Komponenta kryesore që ky koncept synon të ruajë është shpirti bashkëpunues mes komunitetit dhe i komunitetit me qytetin. Kjo arrihet përmes krijimit të hapësirave të domosdoshme në plotësimin e nevojave elementare të shtruara dhe përfilljen e specifikimeve dalluese të moshave, profileve të ndryshme dhe aftësisë së barabartë në shfrytëzim.

Për të arritur rezultate të tilla është propozuar shfrytëzimi i hapësirave të brendshme të bunkerit në dy karaktere të ngjajshme sa i përket fleksibilitetit në shfrytëzim, por me dallime të dukshme në qëndrueshmëri.




Fig. 3 Paraqitja aksonometrike e përmbajtjeve të bunkerit në gjendjen ekzistuese

## 5.1 Përmbajtjet dhe funksionet

Sipërfaqja e bunkerit ndahet në dy hapësira simetrike identike, ku secila hapësirë ka sallën në plan të hapur që kap sipërfaqen prej 175m<sup>2</sup> dhe hapësirat e ndara përcjellëse. Për të konstruktuar konceptin në formë të qartë, sallat janë emërtuar si Salla 1 dhe Salla 2.

Salla 1, e ashtuquajtur “salla e komunitetit”, parashihet të shfrytëzohet për aktivitetet e përditshme të banorëve, ku parashihet mbulimi i kërkesave dhe nevojave të të rinjve, fëmijëve, qytetarëve të rritur dhe të të moshuarve. Si aspekt i rëndësishëm dhe i domosdoshëm në konceptin gjithëpërfshirës është edhe qasja e përshtatshme në këto hapësira për të gjithë, ku rëndësi e veçantë i kushtohet personave me aftësi të kufizuara. Adaptimi i hapësirave qasëse për të takuar nevojat e personave me aftësi të kufizuara ndikon në përmirësimin e qasjes edhe për të moshuarit, prindërit me karrocë fëmijësh, personat me lëndime të përkohshme etj. Salla 1 propozohet të akomodojë programe ekstrakurrikulare të edukimit konvencional dhe atij jo-formal për fëmijë përmes rregullimit të hapësirave të përshtatshme për kurse dhe trajnime të ndryshme, hapësira për punë dhe takim për të rinj, si dhe hapësirë për takimet periodike të komunitetit. Për të shfrytëzuar në maksimum kapacitetin e sallës, të dalat nga programet e kurseve në formë të ekspozitave apo prodhimeveve tjera mund të ekspozohen në pjesë të ndryshme të hapësirës, ku rezultatet janë të prekshme dhe fëmijët dhe pjesëmarrësit tjerë njihen me të arriturat e programeve të zhvilluara. Kjo formë e organizimit ndihmon të mësuarit e të rinjve në fushën e vetëorganizimit dhe vetëiniciativës si pjesë e rëndësishme e zhvillimit të tyre të shëndetshëm.

Sa i përket hapësirave ndihmëse, struktura e brendshme e bunkerit tashmë ka të parapara ndarjen e kthinave sanitare dhe të hapësirave tjera më të vogla, të cilat në rastin konkret të konceptit të vizionit mund të shfrytëzohen për organizimin e kuzhinës doracake, deposë për pajisje, garderobës dhe kthinave teknike.

Salla 2, apo e emëruar si “salla e qytetit”, përfshin të njejtën sipërfaqe, por me karakter më të lirë. Ajo propozohet të marrë rolin e katalizatorit të gjallërisë së zonës dhe të të ardhurave për mirëmbajtjen dhe menaxhimin e bunkerit. Salla propozohet të shfrytëzohet për aktivitete rekreative e argëtuese të të rinjve të lagjes, por edhe t'i shërbejë qytetit si hapësirë fleksibile për organizimin e ngjarjeve të vogla kulturore, funksion ky i cili i sjellë atraktivitet lagjes dhe e lidhë atë me pjesën tjetër të qytetit në nivel bashkëpunues.

Aktivitetet e të rinjve të lagjes përfshijnë sportet e vogla të mbyllura si ping-pong, bilardo, shah, pikado, aktivitete fizike të organizuara, si yoga dhe aerobik, si dhe hapësira për relaksim dhe socializim, si pranimiti i ngjarjeve të ndryshme të organizuara nga të rinjtë. Avantazhet e të pasurit të një hapësire për aktivitete shoqërore brenda lagjes qëndrojnë në sigurinë e fëmijëve dhe të rinjve, mbikqyrja dhe kujdesi më i lehtë për personat e mitur dhe afërsia me funksionet tjera të përditshme, si banimi, shkolla dhe parku.

Aktivitetet e hapura si pjesë e bashkëpunimit me ato të qytetit përfshijnë shfaqjen e filmave, qoftë në kuadër të festivaleve apo edhe jashtë tyre, shfaqjen e performancave të ndryshme artistike, teatrore e muzikore, ku edhe lagja ndihet më afër me qytetin dhe zhvillimet aktuale.

Me këtë rast, punimet në përmirësimin e kushteve të sallave janë të domosdoshme, ku bëhet adaptimi i tyre në përputhje me kërkesat e ngjarjeve. Kjo synohet të arrihet me izolimin e mirë akustik, termik, dhe hidrologjik, me modalitet të hapësirave të cilat rriten apo zvogëlohen në përmasa varësisht nga funksioni i kërkuar, dhe vendosjen e pajisjeve të nevojshme të zërit dhe ndriçimit. Hapësirat ndihmëse këtu marrin rol të madh në përshtatjen e hapësirave për raste të ndryshme, ku bëhet ruajtja dhe zëvendësimi i pajisjeve në çdo organizim. **Fig 4, fig. 5, fig. 6.**

Më poshtë, është paraqitur tabela me funksionet kryesore dhe materialet e duhura për adaptim të hapësirave në të gjitha rastet.

<b>Salla 1 – Salla e komunitetit</b>	Materialet e nevojshme për adaptim
Mbledhjet e komunitetit Stimulimi i bashkëpunimit mes banorëve Kultivimi i vetëiniciativës dhe organizimit te të rinjtë	Mobilier i lëvizshëm (tavolinë dhe karriga për mbledhje dhe prezantime), hapësira dhe mobiluar (tavolina, karriga dhe tabelë) për lexim, socializim e punë në grup. Mjetet për kuzhinën doracake, deponë dhe nyjet sanitare, pajisjet për ndriçim.
Edukimi formal dhe jo-formal	Mobilier për organizimin e kurseve (tavolina, karriga, panele apo tabelë e lëvizshme)

Tabela 1 Funksionet kryesore të Sallës 1 dhe materialet e nevojshme për adaptimin e tyre



<b>Salla 2 – Salla e qytetit</b>	Materialet e nevojshme për adaptim
Aktivitete fizike/sportive	Tavolinat për sporte, si shah, ping-pong, futboll, bilardo. Mjetet e nevojshme për ushtrime fizike, yoga dhe aerobik.
Hapësirë për socializim	Mobiliari i nevojshëm për këto hapësira – Tavolina, ulëse të ndryshme të lëvizshme, bar i vogël. Rregullimi i kthinave ndihmëse – nyjet sanitare, kuzhina doracake/bar, depo.
Ngjarje kulturore të hapura (festival/manifestime aktuale të qytetit)	Ulëse fleksibile për numër më të madh vizitorësh, bar i vogël, projektor i materialeve filmike, pëlhurë për projeksion, panele të lëvizshme për aranzhimin e hapësirës për performancë, pajisje të zërit dhe ndriçimit.

Tabela 2 Funkcionet kryesore të Sallës 2 dhe materialet e nevojshme për adaptimin e tyre

AKSONOMETRIA Qyteti gjithëpërfshirës  
Bazuar mbi dy punëtoritë e organizuara me banorët e lagjes  
FLEKSIBILITETI/RASTI I Propozim mbi shfrytëzimin e bункerit në Ortakoll dhe hapësirave përreth, Prizren




Fig. 4 Paraqitja aksonometrike e rastit të parë të shfrytëzimit të hapësirave





Fig. 5 dhe fig.6 Paraqitja aksonometrike e rastit të dytë dhe të tretë të shfrytëzimit të hapësirave

## 5.2 Menaxhimi i hapësirës së bunkerit

Duke u nisur nga mendimet dhe propozimet e dhëna në të dy punëtoritë e organizuara me qytetarë dhe përfaqësues të ndryshëm, në njërën nga të cilat ishte prezent edhe një përfaqësues nga komuna e Prizrenit, për funksionim të mirë dhe afatgjatë, bunkeri duhet të ketë një strategji drejtimi të hapësirës dhe të vetëqëndrueshmërisë në aspektin financiar dhe programor.

Për këtë arsye është synuar një balancë në programin e hapësirës, duke tentuar akomodimin e funksioneve në proporcion me planin e qëndrueshmërisë dhe drejtimin e saj.

Ndarja e sipërfaqes së brendshme në dy hapësira të ndara që funksionojnë në mënyrë të pavarur i kontribuon këtij plani. Ajo sjell diversitet në program duke vënë dallimin mes hapësirës së dedikuar komunitetit të lagjes dhe asaj për shfrytëzim më të gjerë, e cila njëkohësisht i sjellë të ardhura objektit dhe ndihmon në qëndrueshmërinë e tij ekonomike.

Shfrytëzimi periodik për shfaqjet e ndryshme kulturo-artistike të qytetit i sjellë atraksion dhe llojllojshmëri jo vetëm lagjes, por edhe hapësirave shoqërore të qytetit duke kontribuar në pasurimin e listës së objekteve karakteristike shoqërore. Këtu perfshihen festivalet, ekspozitat e ngjarje tjera kulturore të qytetit.

Me zgjedhjen e grupit drejtues nga komuniteti dhe qyteti në bashkëpunim me komunën, hapësira do të arrijë të jetë e vetëqëndrueshme financiarisht me programin që ofron përgjatë tërë vitit, si dhe të gëzojë drejtimin dhe menaxhimin e duhur krahas mbështetjes dhe mikpritjes së aktiviteteve të caktuara brenda lagjes dhe në bashkëpunim me qytetin. **Fig. 7, fig.8, fig. 9, fig. 10.**



Fig. 7 Rasti i parë i shfrytëzimit të Sallës 1 për aktivitetet e komunitetit



Fig. 8 Rasti i dytë i shfrytëzimit të Sallës 1 për aktivitetet e komunitetit



Fig. 9 Rasti i parë i shfrytëzimit të Sallës 2 për aktivitete të lira ditore



Fig. 10 Rasti i dytë i shfrytëzimit të Sallës 2 për aktivitete të programit kulturor të qytetit

### 5.3 Parku – Hapësira e përbashkët e hapur e bllokut të banimit

Përderisa hapësirat e brendshme të bunkerit dhe gjendja e tyre ishin informata të reja për banorët, meqë shumë nga ta nuk kishin pasur asnjëherë rastin të hyjnë në të dhe shumë nga ta e njihnin vetëm nga dëftimet e të tjerëve, parku mbi bunker është hapësira të cilën të gjithë pjesëmarrësit e njohin mirë dhe e shfrytëzojnë.

Bazuar në vizitën dhe vëzhgimin në terren, hapësira e parkut është e mirëmbajtur, por ka mungesë të elementeve primare të funksionimit si hapësirë e përbashkët e banorëve.

**Fig. 11.**

**PLANI I LAGJES** Qyteti gjithpërfshirës  
**GJENDJA EKZISTUESE** Bazuar mbi dy punëtoritë e organizuara me banorët e lagjes  
 Propozim mbi shfytëzimin e bunkerit në Ortakoll dhe hapësirave përreth, Prizren




Fig. 11 Plani i zonës përreth parkut të bunkerit – Gjendja ekzistuese

Ajo që parasheh vizioni përfshin shtimin e numrit të shtigjeve adekuate përmes parkut, duke u bazuar në vijat e shtigjeve jo-formale të krijuara nga zgjidhja më e shpejtë e shfrytëzuesve si metodë efikase e hulumtimit të lëvizjes së lirë nëpër hapësirë. Ato tregojnë për gjetjen e zgjidhjeve më të thjeshta nga vetë përdoruesit e hapësirës, prandaj janë indikator më i mirë për drejtimin e vizionimit. Me rregullimin e shtigjeve, mundësohet edhe kalimi më i sigurtë për fëmijët pranë shkollës dhe banorëve tjerë përreth që e vizitojnë ose kalojnë përmes parkut.

**Fig. 12**

Krahas rritjes së numrit të qasjeve parashihet edhe pajisja e parkut me mobiluarin urban adekuat në sasi, cilësi dhe dizajn përgjatë shtigjeve për kalim dhe hapësirave të gjelbra, shtimi i sipërfaqeve me gjelbërim të mesëm dhe të lartë për të prezantuar llojllojshmëri të trupave të gjelbër, rregullimi dhe pozicionimi adekuat i këndit të lojërave për fëmijë dhe pajisja me elemente të përshtatshme për lojë dhe ushtrime fizike, rregullimi i fushave ekzistuese sportive dhe pajisja e shtigjeve dhe hapësirave përreth me trupa ndriçues në sasinë e duhur, për të rritur nivelin e performimit të hapësirës edhe në aspektin e sigurisë. **Fig. 13**

Blloku i banimit i studiuar në projekt me sipërfaqet përreth dhe bunkerin karakteristik ka potencial të madh për shndërrim në zonë të gjelbëruar urbane. Ndërtimi me plan dhe ruajtja e hapësirave të lira rreth objekteve shumëbanesore mundëson mbjelljen e shumë trupave të gjelbër, të cilët rrisin kualitetin e hapësirës dhe jetesës në lagje.

Ky faktor prezanton mundësinë e krijimit të një “pylli të vogël urban” (Urban Forest) të qytetit, për të cilin ai ka shumë nevojë. **Fig. 14, fig. 15.**

**LIDHJET DHE  
PËRMBAJTJET E PARKUT**

Qyteti gjithpërfshirës  
Bazuar mbi dy punëtoritë e organizuara me banorët e lagjes  
Propozim mbi shfytëzimin e bunkerit në Ortakoll dhe hapësirave përreth, Prizren



Fig. 12 Plani skematik i përmbajtjeve të parkut dhe lidhjeve të parapara nga vizioni



**PLANI I LAGJES** Qyteti gjithpërfshirës  
**SKEMAT** Bazuar mbi dy punëtoritë e organizuara me banorët e lagjes  
 Propozim mbi shfytëzimin e bunkerit në Ortakoll dhe hapësirave përreth, Prizren




Fig. 13 Skema e klasifikimit të elementeve të parapara në vizionin për parkun

**PLANI I LAGJES** Qyteti gjithpërfshirës  
**PROPOZIMI** Bazuar mbi dy punëtoritë e organizuara me banorët e lagjes  
 Propozim mbi shfytëzimin e bunkerit në Ortakoll dhe hapësirave përreth, Prizren



Fig. 14 Plani i paraparë nga vizioni për zonën e parkut mbi bunker



Fig. 15 Simulimi i dukjes 3D të zonës përreth parkut në bazë të vizionit për rregullimin e tij

## **6.0 Përmbyllje**

Vizioni për rishfrytëzimin e hapësirave të bunkerit nëntokësor dhe parkut në lagjen “Ortakoll” bart rëndësi të madhe sa i përket hapave të duhur në përmirësimin e hapësirave publike përmes zgjidhjeve të thjeshta dhe të aplikueshme në të gjitha rastet.

Këtu përfshihet përfillja e nevojave dhe dëshirave të komunitetit, përpunimi i tyre në baza të organizimit, planifikimit dhe dizajnit të hapësirave dhe objekteve publike, dhe prodhimi i vizionit me pikëpamje gjithëpërfshirëse për mjedise kualitative, me shfrytëzim maksimal të aseteve në dispozicion.

## EC Ma Ndryshe

Organizata jo-qeveritare EC Ma Ndryshe u themelua në mars të vitit 2006. Qëllimet kryesore të organizatës janë: promovimi i qytetarisë aktive dhe pjesëmarrëse dhe ngritja e vetëdijes qytetare për mbrojtjen dhe kultivimin e trashëgimisë kulturore. EC Ma Ndryshe është ndër themelueset dhe përfaqëson Kosovën në Rrjetin e Evropës Juglindore të organizatave që merren me trashëgimi kulturore–SEE Heritage Network. Gjithashtu, është themeluese e Forumit të Trashëgimisë Kulturore të Prizrenit, Rrjetit të Organizatave Kulturore të Prizrenit dhe Rrjetit të Organizatave të Pavarura të Kulturës në Kosovë–Forum Kulturor. EC Ma Ndryshe, që nga themelimi më 2006 është duke ushtruar presion direkt ndaj qeverisë lokale të Prizrenit për t'i krijuar qasje shoqërisë civile dhe qytetarëve për bashkë vendimmarrje. Përveç pjesëmarrjes direkte në proceset e konsultimeve publike, EC Ma Ndryshe ka avokuar rregullisht për respektimin e obligimeve ligjore për konsultime publike, përfshirjen sa më të gjerë komunitare në konsultime publike dhe përfshirjen e shqetësimeve dhe kërkesave të komunitetit në dokumentet e politikave publike.

Projektet kryesore: Aktivizmi kulturor dhe urban në Prizren (2014–2015), Lidhja e komunitetit me shërbyesit e drejtësisë (2014), Urbanism Eatch–Urbanizmi i Prizrenit nën vëzhgim të përhershëm (2013–2014), Pjesëmarrja qytetare përmes medias sociale në Prizren dhe Gjilan (2013–2014), Qyteti gjithëpërfshirës–planifikimi me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren (2013–2015), Trashëgimia kulturore, shtyllë qendrore për zhvillim të qëndrueshëm lokal dhe rajonal në Prizren (2013–2014), Vullnetarët e Kulturës (2012–2013), Pjesëmarrja qytetare në hartimin dhe zbatimin e politikave kulturore në komunën e Prizrenit (2012–2013), Transparenca online e komunës së Prizrenit, Mamushës dhe Prishtinës(2012-2014), Roli i shoqërisë civile në promovimin e trashëgimisë kulturore (projekt rajonal) 2011–2013, Një përrallë ballkanike, trashëgimia otomane në Ballkan (projekt rajonal) (2011–2013), Ngritja e vetëdijes kulturore tek të rinjtë përmes dokumentarëve (2010), Forcimi i veprimit qytetar për promovim dhe mbrojtje të trashëgimisë kulturore (2009), Planorma “Culture 2013” (2008–2009), Kampet e Restaurimit (2007, 2008 & 2009), Forumet e Hapura Qytetare (2007), Ditët e Trashëgimisë Evropiane në Kosovë (2006, 2007 & 2008), Zambaku i Prizrenit 2006.

Publikimet: A ka dalje nga qorrsoakaku urbanistik i Prizrenit?, Ku është Kalldrëmi i Prizrenit?, Harta e shtëpive të vjetra të Prizrenit, Paraja publike si “paret e babës” (2014), Rinia dhe Transparenca: Përparim apo stagnim? (2014), Dokumentari-Sa aktiv, aq transparent? (2014), Udhëzues për Transparencën në Komunë (2014), Ligjet nuk po e mbrojnë Qendrën Historike (2014), Urbanizmi si lexim i qytetit (2014), Qendra Historike e Prizrenit– zonë e (pa)mbrojtur (2014), Qyteti gjithëpërfshirës (2014), Kush mbikëqyr mbikëqyrësit–llogaridhënia e shoqërisë civile në Kosovë (2013), Rinia dhe Transparenca: Të përjashtuar apo të injoruar? (2013), Planifikimi Urban për Qytetarët (2013), Pjesëmarrja qytetare në hartimin e politikave kulturore në Prizren (2013), Prizreni “Qyteti i kulturës”-film dokumentar (2013), Gabim pas gabimi–analizë mbi gabimet e panumërta dhe të vazhdueshme në trashëgimi kulturore (2013), Pesë analiza të projektit “online Transparency”,; 1. Një vit monitorim për më shumë transparencë 2. Degradimi Natyror dhe Urbanistik, 3. Respektimi i ligjit në qeverisjen lokale, 4. Qeverisja e mirë nuk është fjalë goje, 5. Transparenca e qeverisjes lokale në Prizren(2012–2013), Silent Balkan, film dokumentar i projektit “A Balkan Tale” (2012), Jeta kulturore në komunën e Prizrenit (në bashkëpunim me Teatrin ODA) (2010-2011), Prizreni në Retrovizorë, krahasim i fotografive të vjetra dhe të reja të Prizrenit (2009), Vullnetarizmi dhe Trashëgimia Kulturore (2009), Intervenimi me kosto të ultë (2009), Dokument Strategjik mbi organizimin e Ditëve të Trashëgimisë Evropiane në Kosovë (2008), Trashëgimia Kulturore dhe Turizmi Kulturor në Prizren (2008), Hapësirat Kulturore në Kosovë (në bashkëpunim me Teatrin ODA) (2008).